



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 05 Janar 2022

Nr: 02

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE
NR. 75, DATË 16.12.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.01.2022, me pjesëmarrjen e:

Ilijan RUSMALI - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: 1. Dritan Dango; 2. Emirjan Hasa; 3. Blerta Nure; 4. Krisa Lani

OBJEKTI: Kërkesë për rishikim të pikës nr. 4, të vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për QV-në nr. 1943, KZAZ 38

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, shkronja “b”, neni 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pika 8 e nenit 9 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”



Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar me vendimin nr. 470, datë 03.12.2021 raportin e administratës së KQZ-së mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e fletëve të votimit dhe e materialit zgjedhor të 519 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë) qendrave të votimit dhe raportit e saj mbi gjetjet nga këqyrja paszgjedhore e të dhënave të pajisjeve të votimit elektronik dhe dokumentacionit zgjedhor të zonës së administrimit zgjedhor nr. 40, qarku Tiranë.
2. Mbështetur në gjetjet e këtyre raporteve, Komisioneri ka komunikuar vullnetin institucional për t'i kërkuar KAS-it vendosjen e sanksioneve administrative ndaj një numri sekretarësh të komisioneve të qendrave të votimit dhe për të bërë kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara ndaj një grupi anëtarësh të grupeve të numërimit.
3. Anëtarët e GN nr. 03 të KZAZ nr. 38 Emirjan Hasa (numërues i parë), Blerta Nure (sekretare), Dritan Dango dhe Krisa Lani (anëtarë) kanë depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore “kërkesë për rishikimin e pikës 4 të vendimit 470, datë 03.12.2021”. Kjo kërkesë është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore me nr. 75 regj., datë 16.12.2021, në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor.
4. KAS-i caktoi me short z. Ilirjan Rusmali relator dhe vendosi zhvillimin e seancës përgatitore në datën 05.01.2022, ora 14:00. Në seancë ishin të pranishëm Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së z. Ylli Merkaj me ekipin e administratës së KQZ-së. Seanca u zhvillua në mungesë të subjekteve ankuese, të cilët ishin njoftuar rregullisht për zhvillimin e seancës.

KAS-i konstatoi:

1. Objekti i vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 të Komisionerit është miratimi i raporteve me gjetjet nga procedura e verifikimit rastësor të 519 qendrave të votimit dhe nga verifikimi i gjithë qendrave të votimit të zonës zgjedhore nr. 40. Subjektet ankuese nuk kanë kundërshtuar në rrugë administrative asnjë nga gjetjet e konfirmuara nga Komisioneri nëpërmjet miratimit të tij, duke mos shprehur asnjë prapësim rreth këtij objekti të vendimit dhe as ndaj procedurës që është zbatuar për marrjen e tij.
2. Pika 3 dhe pika 4 e vendimit nr. 470, datë 03.12.2021 nuk janë pjesë e lëndës së vendimit, por janë kumtim i vullnetit institucional për të ndjekur rrugën ligjore dhe për t'iu drejtuar KAS-it dhe organit të prokurorisë, sipas kompetencës, për të gjitha rastet kur Komisioneri gjykon se



gjetjet duhet të çojnë në procedim disiplinor ose procedim penal. Vendimi qendron edhe sikur pikat 3 dhe 4 të tij të hiqen nga dispozitivi i vendimit, sikurse detyrimi i Komisionerit për të ndjekur rrugën ligjore nuk shuhet edhe sikur KAS-i të shfuqizojë pikën 3 ose pikën 4 të vendimit.

3. Komisioneri nuk nis dot procedimin penal, sepse kompetenca i përket ekskluzivisht organit të prokurorisë. Po ashtu, kur vendos të bëjë kallëzimin penal komisioneri nuk është duke ushtruar një kompetencë të vetën, por është duke kryer një detyrim ligjor, i cili buron nga pika 3 e nenit 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”. Sipas kësaj dispozite, kur zbulon përgjatë ushtrimit të kompetencave të veta një fakt, i cili përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, Komisioneri është i detyruar që të bëjë kallëzim penal.
4. Një çështje, e cila nuk është kompetencë e Komisionerit dhe nuk i nënshtrohet pushtetit të tij diskrecial, nuk mund t’i nënshtrohet ankimit administrativ, sepse po ashtu nuk bëhet dot kompetencë e KAS-it. Subjektet ankuese kanë të gjithë të drejtën ligjore që të veprojnë kundër kallëzimit të kryer nga Komisioneri me instrumentat që i njuh ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.
5. Kjo analizë ligjore konfirmohet edhe nga rrethanat e lidhura me çështjen. Komisioneri ka depozituar kallëzimet penale në përputhje me vullnetin e shprehur në dispozitivin e vendimit nr.470, datë 03.12.2021, pa pritur afatet e ankimit ndaj vendimit nr.470, datë 03.12.2021 dhe shqyrtimin administrativ në KAS, duke e lënë de fakto ankimin pa objekt.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21 dhe 130, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 17, pika 3, shkronja “b” dhe neni 18, pika 1, shkronja “a” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 75, datë 16.12.2021 të paraqitur nga Anëtarët e GN nr. 03 të KZAZ nr. 38 Emirjan Hasa (numërues i parë), Blerta Nure (sekretare), Dritan Dango dhe Krisa Lani (anëtarë).



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan RUSMALI - Relator

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar